

## Deklaratë për shtyp për Javen Europiane të SME-ve. 25 maj - 1 qershor 2010

Java Europiane e SME-ve është një fushatë pan Europiane e koordinuar nga Komisioni Europian, Drejtoria e Përgjithshme e Ndërmarrjeve dhe Industrisë, që udhëhiqet nga principet e Small Business Act. Shqipëria i bashkohet për herë të parë kësaj nisme dhe është e angazhuar

për të stimuluar veprimtarinë në fushën e SME-ve në nivel kombëtar apo rajonal dhe për të

mundësuar sjelljen e eksperiencave dhe praktikave më të mira, me qëllim për të promovuar arritjet e tyre.

Zhvillimi i sektorit privat, në vecanti i SME-ve, është një ndër prioritetet e qeverisë.

Aktualisht në vendin tonë operojnë rreth 105 mijë ndërmarrje të vogla dhe të mesme, që kontribuojnë në mbi 80% të GDP. SME-të përfaqësojnë 99.9 % të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve dhe mbulojnë rreth 82 % të numrit të përgjithshëm të punonjësve.

Sipas raportit të Progresit të politikave për SME-të 2009 të OECD, Shqipëria ka bërë përpjekje të mëdha në disa fusha si: në hapjen e një biznesi shpejt dhe me kosto të ulët, në reformën rregullatore në reduktimin e barrierave administrative për marrjen e licensave, në sistemin e taksave duke ulur barrën fiskale, nepermjet taksës së sheshtë prej 10 % dhe duke reduktuar tatimin për sigurimet shoqërore nga 20% në 15%.

Gjatë vitit 2010 po zbatohen disa projekte të rëndësishme në mbështetje të zhvillimit të SME-ve si:

- Programi italian për mbështetjen e SME-ve nëpërmjet një linje kredie të butë prej 25 milion Euro dhe fondi garantimi prej 2,5 milion Euro. Deri tani janë dhënë kredi për 19 kompani me një vlerë prej 5 milion Euro. Për vitin 2010 po bëhet efektivi për disbursim transhi i dyte prej 10 mln.Euro.
- Programi për përmirësimin e menaxhimit të kompanive TAM/BAS, IPA 2007, me një vlerë prej 1 milion Euro, me të cilën janë duke u asistuar 18 kompani.
- Funksionimit të Qendrës Kombëtare të Licensave si një one stop shop, i është shtuar edhe aktiviteti i aplikimeve energjetike.
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë dhe produktivitetin në SMEtë shqiptare, në 10 qytete kryesore, projekt i mbështetur nga USAID, me një vlerë prej 10. milion USD (Competitiveness Enterprises Development, CED project).
- Vazhdimi i Fondit të Konkurrueshmërisë së SME-ve eksportuese prej 28 mln leke/vit për periudhën 2010-2012.
- Fondi i Garantimit të Kredive në Eksport prej 200 milionë leke/6 vjet.

Marrëveshjet e tregtisë së lirë në rajonin e Ballkanit Perëndimor (CEFTA) dhe zbatimi i MSA-së me BE-në, ka nxjerrë në evidence nevojën për tu fokusuar edhe me shume në ato faktorë që ndikojnë në përmirësimin e konkurrueshmërisë së vendit.

Duke u krahasuar me vendet e rajonit, ne sektorin e SME-ve konsiderohen ende kritike niveli zhvillimit te siper marrjes dhe inovacionit, qe perbejne bazen standardeve të BE-së dhe qe jane tregues për matjen e performancës se tyre.

Për të adresuar këto mangësi, METE, referuar Strategjise se Lisbonës dhe ne vecanti kundrejt Small Business Act, po punon në kërkim të instrumentave më të mirë të cilet do të mundesojne qe SME-te në Shqipëri të ecin dhe zhvillohen sipas ritmit të sipërmarrjes, inovacionit dhe zhvillimeve teknologjike në BE.

Shqipëria aktualisht ende ka mungesë të infrastrukturës që lejon zhvillimin dhe promovimin e inovacionit dhe teknologjive te avancuara me qellim për të arritur konkurrueshmërinë. Ndjehet mungesa e inkubatorëve te biznesit, parqeve teknologjike etj, instrumenta që stimulojne zhvillimin e SME-ve inovative.

Ende mungon një bashkëpunim aktiv midis universiteteve dhe SME-ve në çështje të inovacionit dhe teknologjisë.

Projekti FP 7, i Bashkimit European dhe iniciativat e CIP ku tashme Shqipëria ben pjese, shikojme si mekanizma qe duhet te inkurajojne bashkëpunimin e universiteteve tona me SME-te, per nje angazhim me te madh për R&D, per te nxitur thithjen e trurit nga jashte dhe për të ofruar kushte me te mira per biznese inovative.

Ketyre shqetesimeve qe sot hasin SME-te ne Shqiperi, jemi te bindur se projekti IPA 2007 qe ne kemi filluar te zbatojme, do ti jape zgjidhje konkrete shume prej ketyre mangesive te konstatuara, sic jane; strategjia e inovacionit, qendra e ndermjetesimit per inovacionin, programi per konkurrueshmerine etj. Njekohesisht ky projekt eshte ne koherence me objektivin e projektit rajonal te OECD, "Iniciativa e Konkurrueshmerise Rajonale" qe pritet te filloje se shpejti.

Jemi te bindur se java Europiane e SME-ve do te sherbeje si nje vlere e shtuar si per qeverine dhe organizatat e biznesit, per ta kthyer ate ne programe per veprim, ne mbeshtetje te rritjes se konkurueshmerise se SME-ve.